REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

**AKT NORMATIV**

**Nr._____, datë ____________**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.90/2019, "PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 1 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, fjalët "... deri në datën 31 dhjetor 2021 ..." zëvendësohen me "... deri në datën 30 prill 2022 ...";

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

   "1.1. Parashikimi i pikës 1, të këtij neni, zbatohet edhe për kërkesat e dorëzuara pranë ASHK-së, të cilat nuk kanë përfunduar brenda datës 30 prill 2022, në rast se pagesa e tatimit për to bëhet para datës 31 korrik 2022.".

**Neni 2**

Në nenin 5, fjalët "... dhe i shtrin efektet deri në datën 31 dhjetor 2021 ..." zëvendësohen me "... dhe i shtrin efektet deri në datën 30 prill 2022 ...".

## Neni 3

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ